


# Ekvivalenca e diplomave të huaja në Belgjikën Frankofone



Udhëzues për të ju ndihmuar në pregaditjen  
e dosjes për ekuivalencë

The logo for CIRÉ, featuring the word "CIRÉ" in a bold, blue, sans-serif font. Above the letters "I" and "R" are three small orange dots. Above the letter "É" is a stylized orange arrow pointing to the right.

Hyrje	3
Ekuivalencat e diplomave	4
Qka duhet të futni në dosjen e ekuivalencës së diplomës ?	5
Pyetje/Përgjigje	7
Ju e keni një diplomë të arsimit të lartë ose univerzitarë të një shteti të huaj dhe ju dëshironi të bëni ekuivalencën ?	13
Refuzimi i ekuivalencës ose ekuivalenca e kufizuar	16
Alternativat tjera...	17
... E pranë Komunitetit Flaman të Belgjikës?	19
Adresa praktike	20

Ekuivalenca e diplomës në shumicën e rasteve është piknisje për të gjithë migrantët të cilët vijnë në Belgjikë dhe të cilët dëshirojnë të konkretizojnë projektet e tyre personale dhe profesionale.

Kydoracak për ekuivalencën e diplomave është fryt i punës së informimit dhe shoqërimit (ndihmës) që CIRÉ-ja, asociacionet anëtare dhe partënerët e sajë kanë realizuar që prej disa viteve. Konstatimet e shumnumërta në lëminë e ekuivalencave të diplomave të huaja të mbledhura nga ana e CIRÉ-së përbëjnë bazën e këti udhëzuesi i cili tenton të sjellë përgjigje në pyetjet e migrantëve të cilët arrijnë në Belgjikë.

Ky dokument është në dispozicion në versionin për printim dhe poashtu në sitin e internetit të CIRÉ-së në 6 gjuhë : frengjisht, anglisht, spanjollisht, arabisht, ruisht, dhe shqip. Për informata më të detajuara, një tjetër udhëzues është në dispozicion në sitin e internetit të CIRÉ-së në frengjisht i destinuar migrantëve dhe profesionistëve në shoqërimin (ndihmën) sociale.

Ky udhëzues praktik është version sintetik i ligjeve dhe praktikës në lëminë e ekuivalencave të diplomave të huaja në Belgjikën frankofone. Informatat zyrtare mund të konsultohen në udhëzuesin e printuar dhe në sitin e internetit të Federacionit Valoni-Bruksel.

<http://www.federation-wallonie-bruxelles.be>




## Qka është ekuivalenca ?

Ekvivalenca është një dokument i cili determinon vlerën e studimeve të bëra në një shtet tjetër (të huaj). Ajo ipet në bazë të dokumenteve shkollore.

## Pse të bëhet kërkesa e ekuivalencës së diplomës ?

- Për të vazhduar ose rifilluar studimet (e mesme ose të larta)
- Për të ushtruar një punë (për shembull : pranë shërbimit publik ose një profesion të normatizuar) dhe të shfrytëzoni nivelin e pagesës legale të caktuar sipas nivelit të studimeve.
- Për të filluar një formacion profesional





## Qka duhet të futni në dosjen e ekuivalencës së diplomës ?

### Nëse dëshironi të vazhdoni studimet (mësimin) e nivelit të mesëm

1. Një shkresë e motivimit e cila përmban mbiemrin tuaj, emrin, adresën complete dhe studimet që dëshironi ti bëni (për shembull : dëshiroj të vazhdoj vitin e 4-t të shkollës së mesme drejtimin e përgjithëshëm pranë shkollës Z). Ose shkarkoni formularinë në <http://www.equivalences.cfwb.be>
2. 3 dëftesat shkollore të fundit të cilat i keni marë jasht shtetit
3. Një qertifikatë origjinale të lindjes
4. Dëshmia e pagesës prej 25 ose 50 euro (suma e sakt varet nga shteti prej nga vjen diploma( mund të verifikohet pran Feredacionit Valoni – Bruksel) të derdhura në llogarinë : 091-2110516-19<  
(Kodi IBAN : BE 39 0912 1105 1619 - Kodi BIC : GKCCBEBB). Të mos harrohet të vihet në komunikim :  
Mbiemri dhe Emri i kërkuesit si dhe të ceket shprehja "Equivalence de diplôme".

## Nëse dëshironi të vazhdoni studimet e arsimit të lartë

1. Një shkresë e motivimit e cila përmbanë mbiemrin tuaj, emrin, adresën complete dhe studimet e dëshiruara (për shembull : dëshiroj të vazhdoj vitin e 1-rë Bachelor të shkencave ekonomike pranë univerzitetit Z) ose një dokument të shkarkohet.
2. Një qertifikatë origjinale të lindjes
3. Dëshmia e pagesës së sumës prej 124 euro ose 174 auro (suma egzakte varet prej shtetit prej të cilit është dhënë diploma (mund të verifikoni pran Federacionit Valoni – Bruksel). Suma e cekur duhet të paguhet në llogarinë : 091-2110516-19 (Kodi IBAN : BE 39 0912 1105 1619 - Kodi BIC : GKCCBEBB). Të mos harrohet të ceket në komunikim : Mbiemri dhe Emri i kërkuesit si dhe të ceket shprehja "Equivalence de diplôme"
4. Një kopje e vërtetuar e diplomës të studimeve (shkollës) të mesme. Për diplomat e viteve në vijim : vërtetimi i përkohëshëm i suksesit. Diploma definitive duhet të dorëzohet sapo të jet marë.

**Ju duhet gjithsesi të bëni pagesën për 15 korrik (afati i fundit). Në të kundërtën, dosja juaj do të konsiderohet se nuk është bërë në formën e duhur në afatin e paraparë dhe kërkesa juaj nuk do të ketë mundësi të meret parasyshtë për vitin e ardhëshëm akademik.**



**Ky afat është për kërkesa të ekuivalencës. Duhet të informoheni pranë Shkollave të Larta, pranë Univerzitetit ose Shkollës së Lartë të Arteve mbi afatet e tyre të pranimit të cilat zakonisht janë para 15 korrikut.**

5. Një kopje e vërtetuar e notave duhet të shoqërojë diplomën
6. Nëse ju keni pasur rastin të bëni studime të larta në shtetin ku i keni bërë studimet (shkollën) e mesme (për shembull : dëshmia e regjistrimit në univerzitet, qertifikata e notave univerzitare, diploma, etj.). Në këtë rast, është e mundur të merret ekuivalenca e zgjëruar. Është pra me rëndësi të sillni një kopje të vërtetuar të dokumenteve të cilët dëshmojnë një gjë të tillë.

**Nëse kërkesa e juaj për ekuivalencë të diplomës është bërë me qëllim për të punuar ose për të përcjellur një formacion profesional, ju duhet ti bashkangjitni një dokument i cili dëshmon që kërkesa juaj ka për qëllim kërkimin e punësi. Për shembull : vërtetimi i Forem-it, i Actiris-it ose i VDAB-së. Kërkesa mund të bëhet gjatë gjith vitit gjë që është e kundërt sa i përket kërkesës për studime.**

## Si të bëhet vërtetimi konform i dokumenteve të huaja?

### Jasht Shtetit

1. Të bëhet një kopje konform e vërtetuar nga ana e nëpunësit kompetent të shtetit ku janë bërë studimet.
2. Nënshkrimi i këti nëpunësi duhet të legalizohet nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të këti shteti.
3. Nënshkrimi i nëpunësit të Ministrisë së Punëve të Jashtme do të legalizohet pastaj nga ana e Ambasadës ose nga ana e Konsulatës së Belgjikës pranë këti shteti.

### Në Belgjikë

Në rast të deponimit të dosjes në vendë, një nëpunës i shërbimit të ekuivalencës mund të bëjë kopje konform të vërtetuar falas prej dokumenteve origjinale. Është poashtu e mundur ti drejtoheni Administratës komunale, por kjo procedurë është me pagesë.



## Si të përktheni dokumentet tuaja ?

Nuk duhet bërë përkthimin e dokumenteve të huaja nëse ato janë të shkruara në frengjisht, gjermanisht, anglisht, spanjollisht, italisht, holandisht ose portugalisht. Për dokumentet në gjuhët tjera, duhet :

### Jasht Shtetit

1. Të përkthehen nga ana e një përkthyesi të përbetuar. Ai duhet të vëjë vulën dhe nënshkrimin e tijë në pjesën e sipërme të kopjes së dokumentit që dorëzoni dhe pjesërisht mbi përkthimin.
2. Të legalizoni nënshkrimin e përkthyesit nga ana e Ministrisë së Punëve të jashtme të shtetit.
3. Të legalizoni nënshkrimin e nënpunësit të Ministrisë së Punëve të jashtme të shtetit pranë Ambasadës ose pranë Konsulatë Belge pranë këti shteti.

### Në Belgjikë

1. Trouver un traducteur juré en s'adressant à la commune ou au Tribunal de première instance le plus proche.
2. Faire traduire par le traducteur juré et lui rappeler qu'il doit mettre son cachet et sa signature en partie sur la copie du document traduit et en partie sur sa traduction.
3. Faire légaliser la signature du traducteur par le Tribunal de première instance le plus proche.



## Ku dhe si të bëni kërkesën ?

Kërkesa duhet të bëhet pranë shërbimit të ekuivalencave të arsimit të obliguar të Federatës Valoni-Bruksel në vend, ose përmes Postës.

### Në vend

Kujdes : para se të shkoni në vend duhet të merni takim përmes telefonit ose është e mundur të shkoni në vend për të caktuar takimin prej të hënës deri të premten prej 9h00 deri 12h00 dhe prej 13h30 deri 16h00.est complet.

Federata Valoni-Bruksel (Fédération Wallonie-Bruxelles)

Drejtoria gjenerale e arsimit të obliguar (Direction générale de l'enseignement obligatoire)

Shërbimi i ekuivalencave (Service des équivalences - 1, rue A. Lavallée - B-1080 Bruxelles)

Rruga A. Lavallée nr.1 – 1080 Bruksel

Telefoni : 02 690 86 86 – Adresa elektronike : [equi.oblig@cfwb.be](mailto:equi.oblig@cfwb.be)

**Për të gjitha informatat, shërbimi i ekuivalencave mund të kontaktohet përmes telefonit gjatë orëve si në vijim :**

- **Të hënën, marten ,merkrure dhe të premteve prej ores 9h deri 12h**
- **Të enjteve prej 13h30-16h00**

Dorëzimi i dosjes mund të verifikohet në komunitetin Frances nëse dosja është complete. Në momentin e dorëzimit, personi mer një vërtetim të dorëzimit të dosjes. Me numrin e referencës, është e mundur të përcillet avancimi i dosjes në sitin : <http://www.equivalences.cfwb.be>

## Dergesat përmes postës

Federata Valoni-Bruksel (Fédération Wallonie-Bruxelles)  
Drejtoria gjenerale e arsimit të obliguar (Direction générale de l'enseignement obligatoire)  
Shërbimi i ekuivalencave (Service des équivalences - 1, rue A. Lavallée - B-1080 Bruxelles)  
Rruga A. Lavallée nr.1 – 1080 Bruksel

- Dërgesa përmes letrës së rekomanduar nuk është e obliguar por është më se e këshilluar.
- Duhet të provoni ti dërgoni të gjitha dokumentet së bashku në një dërgesë.
- Nëse dosja dorëzohet me qëllim të vazhdimit të studimeve, afati i 15 korrikut është data limit për të dorëzuar atë. Duhet të kujdeseni që dërgesa të bëhet më së largu atë ditë, data e cila merret parasyshtë nga ana e shërbimit të ekivalencave është ajo e cila figuron në vulën e Postës.

## Kur të dorëzohet kërkesa ?

### Për personat që dëshirojnë të studjojnë

Ata duhet të dorëzojnë dosjen mes datave 15 nëntorë dhe 15 qershorë të vitit akademik i cili paraprinë regjistrimin nëse qëllimi është të regjistroheni në shtatore për arsim të lartë.




**Afati prej 15 nëntorit deri 15 korrik është ai i kërkesës për ekuivalencë. Duhet të informoheni pranë shkollës së lartë, UniverFaqja e internetit ose të shkollës së lartë të arteve mbi datat e tyre të pranimit të cilat janë në përgjithësi para datës së 15 qershorit.**

Dorëzimi i dosjeve me vonese është i autorizuar vetëm në rastet si në vijim :

- **Nëse shpallja e rezultateve të diplomës tuaj të fundit të studimeve të mesme ndodhë (bëhet) pas 10 qershorit** (10 qershori duke mos u llogaritur), afati i dorëzimit vazhdohet deri më 14 shtatorë. Në këtë rast, është e obliguar të bashkangjitet me kërkesën për përjashtim, një dëshmi zyrtare të kësaj shpalljeje të vonuar (të lëshuar nga ana e Ministrisë së Arsimit, Akademisë, Zyrës së Diplomave, etj.).
- **Nëse kërkohet kalimi i një provimi pranues.** Personat të cilët dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta pranë Federatës Valoni-Bruksel të cilët kërkojnë kalimin e provimit pranues kanë në dispozicion një afat prej 5 ditëve pune, pas dates së notifikimit të suksesit, për të dorëzuar kërkesën për ekuivalencë. Kjo duhet të jetë e shoqëruar me dëshminë e kalimit (suksesit) të provimit për pranim të lartpërmendur. Në këtë rast, është e obliguar që dosja të përmbajë elementet në vijim : kërkesa për përjashtim, dokumentet shkollore, qertifikatën e lindjes, dëshminë e pagesës dhe vërtetimin e suksesit të provimit pranues.
- **Në rast të rrethanave të jashtëzakonshme.** Është e mundshme të cekën rrethanat e jashtëzakonshme të cilat ua kanë pamundësuar dorëzimin e dosjes në afat. Rrethanat e jashtëzakonshme duhet të nënkuptohen si fakte objektive të cilat kanë bërë që dorëzimi i kërkesës të bëhet jashtë afatit të paraparë dhe se rrethanat të jenë mjaft të jashtëzakonshme për të justifikuar që kërkesa të trajtohet në një afat më të shpejtë se sa kërkesat e dorëzuara në afatin e paraparë.

**Për personat që dëshirojnë të punojnë ose të përcjellin një formacion**

Është e mundshme të bëhet kërkesa për ekuivalencë në gjdo moment të vitit.



## Q\_ka mund të bëni nëse vendimi i ekuivalencës nuk është i mjaftueshëm ?

Në rastë se vendimi i ekuivalencës së diplomës nuk është i mjaftueshëm, është e mundëshme të drejtoheni pranë :

Shërbimi për Ndërmjetsim i Federatës Valoni-Bruksel  
(Service du Médiateur de la Fédération Wallonie-Bruxelles)  
Rruga Poissonnier nr.11-13-1000 Bruksel  
(11-13, boîte 7, rue de Poissonnier - B-1000 Bruxelles)  
Telefoni : 02 548 00 70  
Siti : <http://www.mediateurcf.be> -e-mail : [courrier@mediateurcf.be](mailto:courrier@mediateurcf.be)

Ky shërbim mund të rivendosë komunikimin mes kandidatit dhe administratës dhe të bëjë rekomandime (jo detyruese) pranë administratës. Është poashtu e mundëshme të bëni një ankesë kundër vendimit të administratës pranë Këshillit të Shtetit përmes avokatit. Këshilli i Shtetit nuk e shqyrton dosjen në thelb por kontrollon respektimin e formaliteteve të procedurës nga ana e administratës dhe mund të bie një vendim i cili then vendimin e administratës.

# Ju e keni një diplomë të arsimit të lartë ose univerzitarë të një shteti të huaj dhe ju dëshironi të bëni ekuivalencën ?



**Ekuivalenca është një procedurë me të cilën njihet një diplomë e marë pranë një shteti të huaj e cila nuk është automatike dhe e cila bazohet mbi kritere të ndryshme, dhe veçanërisht :**

- karakteri i njohur i diplomës nga ana e autoriteteve kompetente të shtetit i cili e ka dhënë (lëshuar) diplomën;
- kohëzgjatja e studimeve dhe vëllimi i tyre kohor dhe
- përmbajtja e formacionit (mësimi, stazhi, tema e diplomës).

## Dokumentet që duhet bashkangjitur

- Një letër e motivimit duke precizuar objektin dhe motivin e kërkesës
- Inventarin e pjesëve (dokumenteve) që keni dhënë
- Një kopje të një dokumenti të identitetit (letërnjoftimi i portokallt, pasaporti, etj.)
- Një kopje e diplomës së shkollës së mesme :
  - › Ose një kopje konforme të vërtetuar nga ana e një autoriteti kompetent belg të vendimit të ekuivalencës së diplomës së huaj të studimeve të mesme.
  - › Ose një kopje konforme të vërtetuar nga ana e autoriteteve kompetente belge të diplomës së huaj të studimeve të mesme dhe përkthimin e sajë të bërë nga ana e përkthyesit të përbetuar nëse diploma është e shkruar në një gjuhë tjetër përveq frengjishtes.
  - › Ose një kopje konforme të vërtetuar nga ana e autoriteteve kompetente belge të qertifikatës të homologuar të arsimit të mesëm superior (për studentët të cilët kanë bërë studimet e tyre të mesme në Belgjikë). Në rast të mungesës së ndonjëres prej këtyre pjesëve, një dokument zyrtarë i institucionit të shkollimit të lartë i cili përshkruan kushtet e pranimit në formacion. Nëse ky dokument është i shkruar në gjuhë të huaj, ai duhet të shoqërohet me përkthimin e vet në gjuhën frengje nga ana e përkthyesit të përbetuar.

- Një kopje konforme nga ana e një autoriteti belg kompetent (për shembull : administrata komunale) të diplomës origjinale të studimeve të larta, finale dhe definitive për të cilën kërkohet ekuivalenca (ose vërtetimet e suksesit). Nëse ky dokument është i shkruar në gjuhë të huaj, ai duhet të shoqërohet me përkthimin e tij në gjuhën frenge nga ana e përkthyesit të përbetuar.
- Një kopje konforme e vërtetuar nga ana e një autoriteti belg kompetent të notave (ose referencat) të mara në provimet e ndryshme për çdo vit të studimeve të larta. Nëse ky dokument është i shkruar në gjuhë të huaj, ai duhet të shoqërohet me përkthimin e tij në gjuhën frenge nga ana e përkthyesit të përbetuar.
- Një program mesimor zyrtar i vërtetuar konform nga ana e një autoriteti kompetent belg dhe i detajuar vit pas viti të studimeve të larta të përfunduara dhe që përfshin së paku një titull dhe një përshkrim të shkurtër të çdo lënde të përcjellur, vëllimin e orëve (vlera e njësive dhe përkthimi i tyre në numrin total të orëve) të çdo lënde të përcjellur. Përkthimi mund të bëhet nga ana e vet kërkuesit.
- Një egzemplar të temës së diplomës (memoaret), të projektit ose të tezës së fundit të studimeve të shoqëruar, nëse tema e diplomës nuk është e shkruar në frengjisht, mund të bëhet një përmbledhje në disa faqe në gjuhën frenge, përjashtim bëjnë diplomat në filozofi, histori dhe letërsi ku përkthimi kërkohet të jetë komplet. Përkthimi mund të bëhet nga ana e vet kërkuesit.
- Një vërtetim i detajuar i stazheve të realizuara dhe të vërtetuara në mënyrë konforme nga ana e një autoriteti kompetent belg. Përkthimi mund të bëhet nga ana e vet kërkuesit.
- Një curriculum vitæ (CV).

## Nëse qëllimi është të rifilloni studimet në Federatën Valoni-Bruksel

Duhet të kontaktoni direkt Shkollën e Lartë, UniverFaqja e internetit ose Shkollën e Lartë të Arteve që ju keni zgjedhur me qëllim që ky institucion i arsimit të lartë të vendosë, mbi dosjen, dhe vitin e studimeve në të cilin ju do të mund të pranoheni. Institucioni arsimor i lartë do të shqyrëtojë krahasueshmërinë e studimeve të larta të bëra në një shtet të huaj me ato të dëshiruara në Belgjikë.

Nëse, pas shqyrimit të kërkesës, vendimi i Shkollës së Lartë, i UniverFaqja e internetit ose i Shkollës së Lartë të Arteve e mundëson regjistrimin në një vit të parë (1-rë) të studimeve, ekuivalenca e diplomës së studimeve të mesme do të jetë poashtu e nevojshme. Është pra e domosdoshme ti drejtoheni poashtu shërbimit të ekuivalencave të shkollimit të mesëm të Federatës Valoni-Bruksel.

**Ne ju ftojmë të konsultoni disa institucione shkollore me qëllim të verifikimit të mundësive të ndryshme të ofertave për vazhdimin e studimeve tuaja.**

Siti : <http://www.enseignement.be>

## Nëse qëllimi juaj është të punoni me diplomë universitare në Belgjikë dhe se ekuivalenca është e domosdoshme

Duhet të kontaktoni përmes Faks-it, e-mail-it, telefonit ose të paraqiteni në vend pranë shërbimit të Federatës Valoni-Bruksel :

Shërbimi i njohjes akademike dhe profesionale të diplomave të huaja të arsimit të lartë

1 (kati i 5-të), rue Adolphe Lavallée - B-1080 Bruxelles

Telephone : 02 690 89 00 - Faks : 02 690 88 90

Siti : [www.equivalences.cfwb.be](http://www.equivalences.cfwb.be) - e-mail : [equi.sup@cfwb.be](mailto:equi.sup@cfwb.be)

Ky shërbim mund të kontaktohet përmes telefonit të martën, të mërkurën dhe të premten prej 13h30 deri 16h00.

Shërbimi pranon pa takim të hënave dhe të enjteve prej 13h30 deri 16h00. Këto visita do të kenë për qëllim të ndihmohen personat për të bërë kërkesën dhe për tu orientuar në mënyrë adekuate.



# Refuzimi i ekuivalencës ose ekuivalenca e kufizuar

Në rast të refuzimit të ekuivalencës, egzistojnë disa alternativa për të realizuar studimet e larta :

- Mund të prezentoni provimin pranë juris qendrore për të marrë CESS (Vërtetimi i Arsimit të Mesëm Superior - Certificat de l'Enseignement Secondaire Supérieur). Për më shumë informata, konsultoni sitin <http://www.jurys.cfwb.be/accueil.asp> ose
- Të paraqitni provimin pranues të organizuar nga ana e UniverFaqja e internetit dhe Shkollës së lartë ose
- Të prezentoni provimin pranues të organizuar nga ana e shkollave në promocion social. Lista e shkollave të Federatës Valoni-Bruksel, konsultoni sitin : <http://www.enseignement.be/>

Në rastë të ekuivalencës restriktive (kufizuar) e cila ju limiton regjistrimin për disa studime të larta, alternativat janë :

- Të prezentoni provimin e maturis për të marrë DAES (Diploma e Aftësive për Arsimin e Lartë - Diplôme d'Aptitude à l'Enseignement Supérieur) <http://www.jurys.cfwb.be/accueil.asp> ose
- Të prezentoni provimin pranues të organizuar nga ana e UniverFaqja e internetit dhe Shkollave të Larta ose
- Të prezentoni provimin pranues të organizuar nga ana e shkollave të promocionit social (shkollim me orarë të shkurtuar)



Disa persona kan mësuar një profesion (zanatë), duke punuar me prindin gjat kohës së lirë, një aktivitet benevol, etj. Personat të cilët kan kompetenca por nuk kan titull shkollorë, nuk kan diplomë dhe kjo i frenon në kërkim të punës, në vazhdim të formacioneve ose në evoluim të karrierës. Masat e vlerësimit të kompetencave janë krijuar për të gjithë këta persona. Në të vërtetë, këto masa u mundësojnë të gjithë personave më të vjetër se 18 vite të u njihen (pranohen) kompetencat e tyre në mënyrë zyrtare. Nuk ka rëndësi se në qfar mënyre këto njohuri janë fituar, vlerësimi i kompetencave i shton kapacitetit profesional një vlerë të pranuar në tregun e punës falë titullit të kompetencave.

Për të marë titullin e kompetencave, mjafton të dëshmohet aftësia juaj në profesionin e caktuar duke kaluar testin praktik në situatë reale pranë një qendre të qertifikuar. Është thjeshtë, falas dhe e dobishme!

Konsultoni sitin e internetit : <http://www.cvdc.be>

Ju dëshironi të rifilloni studimet universitare dhe në të njejtën kohë të vlerësoni eksperiencën tuaj profesionale. Ju mund ta bëni këtë përmes

**Qendra Inter-Universitare frankofone**  
**Centre Inter-Universitaire Francophone (CIUF)**  
5, rue d'Egmont - B-1000 Bruxelles  
Telephoni : 02 504 92 91 - Faks : 02 502 27 68

Siti: <http://www.ciuf.be/cms/la-plateforme-interuniversitaire-pour-la-vae.html>

vlërësimi të eksperiencës së fituar (VAE). Për më shumë informata, kontakti :

Është e mundëshme të bëheni ndërmarrës ose i pamvarur, me ose pa diplomë. Në këtë drejtim, është interesant të konsultohet siti i internetit të ministrisë së klasave të mesme (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) për të verifikuar diplomat të cilat mundësojnë të dëshmojnë kapacitetet ndërmarrëse, që do të thotë njohurit e udhëheqjes bazë dhe kompetenca profesionale.

Konsultoni sitin e internetit :

[http://economie.fgov.be/fr/entreprises/vie\\_entreprise/Creer/Conditions/](http://economie.fgov.be/fr/entreprises/vie_entreprise/Creer/Conditions/)

Për më shumë informata :

SPF Économie, P.M.E., Classes moyennes et Énergie  
Direction générale de la Politique des P.M.E.  
Service des Guichets d'Entreprises  
WTC III, 18e étage  
30, Boulevard Simon Bolivar - B-1000 Bruxelles  
Telefoni : 02 277 74 86 - Faks : 02 277 98 78  
E-mail : [gea@economie.fgov.be](mailto:gea@economie.fgov.be)

# ... E pranë Komunitetit Flaman të Belgjikës?



**Nëse dëshira juaj është të studjoni në Komunitetin Flaman, ju duhet të bëni kërkesën tuaj gjithsesi pranë Komunitetit Flaman. Personat të cilët jetojnë në Bruksel dhe të cilët dëshirojnë të punojnë me ekuivalencat e diplomave të tyre mund të zgjedhin Federatën Valoni-Bruksel ose Komunitetin Flaman.**

Të gjitha informatat mund të meren pranë :

Vlaams Ministerie van Onderwijs en Vorming  
Agentschap voor Kwaliteitszorg in Onderwijs en Vorming  
Afdeling Dienstverlening EVC  
Hendrik Consciencegebouw - Toren C - 2de verdieping  
15, Avenue Koning Albert II-laan - B-1210 Bruxelles  
Telefoni : 02 553 89 58

Faqja e internetit <http://www.ond.vlaanderen.be/naric/> - e-mail : [naric@vlaanderen.be](mailto:naric@vlaanderen.be)

## Shërbimi i ndihmës dhe i shoqërimit për marjen e ekuivalencës së diplomës

### Në Bruksel

#### CIRÉ (Coordination et Initiatives pour Réfugiés et Étrangers)

80-82, rue du Vivier - B-1050 Bruxelles

Telefoni : 02 629 77 10

Faqja e internetit: <http://www.cire.be>

#### Convivial

Service de Guidance Socioprofessionnelle

33-35, rue du Charroi - B-1190 Bruxelles

Telefoni : 02 503 43 46 - GSM : 0488 28 31 64

Faqja e internetit : <http://www.convivial.be/> - e-mail : [guidance@convivial.be](mailto:guidance@convivial.be)

#### Infor-Jeunes Bruxelles (Centre Ville)

155, rue van Artevelde - B-1000 Bruxelles

Telefoni : 02 514 41 11 - Fax : 02 502 68 19

e-mail : [bruxelles@inforjeunes-bxl.be](mailto:bruxelles@inforjeunes-bxl.be)

#### Infor jeunes Bruxelles Nord-Ouest (Laeken)

360d, Boulevard Emile Bockstael - B-1020 Bruxelles

Telefoni : 02 421 71 31 - Fax : 02 421 71 36

e-mail : [laeken@inforjeunes-bxl.be](mailto:laeken@inforjeunes-bxl.be)

#### Service social de Solidarité Socialiste (SESO)

26, rue de Parme - B-1060 Bruxelles

Telefoni : 02 533 39 84 - Fax : 02 534 62 26

e-mail: [info@seso.be](mailto:info@seso.be) - Faqja e internetit : <http://www.seso.be>

#### Centre Social Protestant

12, rue Cans - B-1050 Bruxelles

tél. : +32 2 512 80 80 - fax : +32 2 512 70 30

e-mail : [csp.psc@skynet.be](mailto:csp.psc@skynet.be) - Faqja e internetit : <http://www.csp-psc.be>

### Cap Migrant

98, rue de Fétines - B-4020 Liège  
Telefoni : 04 222 36 16 - Fax : 04 342 47 77  
e-mail : [sse@swing.be](mailto:sse@swing.be)

### CIMB - Centre Interculturel de Mons et du Borinage

Siège d'exploitation  
56, Rue Grande - B-7330 Saint-Ghislain  
Telefoni : 065 61 18 50 - Fax: 065 43 00 48  
e-mail: [cimb@skynet.be](mailto:cimb@skynet.be) - Faqja e internetit : <http://www.cimb.be>  
Siège social  
4, Grand-Place - B-7012 Jemappes

### Ce.R.A.I.C. - Centre Régional d'Action Interculturelle du Centre

43, Rue Dieudonné François - B-7100 Trivières  
Telefoni : 064 23 86 56 - Fax : 064 26 52 53  
e-mail : [ceraic@swing.be](mailto:ceraic@swing.be) - Faqja e internetit : <http://www.ceraic.be>

### Centre d'action interculturelle de la province de Namur

2, Rue Docteur Haibe - B-5002 Saint-Servais (Namur)  
Telefoni : 081 73 71 76 - Fax 081 73 04 41 - Faqja e internetit : <http://www.cainamur.be>

### Centre Régional de Verviers pour l'Intégration

17, Rue de Rome - B-4800 Verviers  
Telefoni : 087 35 35 20 - Fax : 087 35 55 20 - Faqja e internetit : <http://www.crvl.be>

### CRIBW - Centre Régional d'Intégration du Brabant wallon

17/1, Rue de Mons - B-1480 Tubize  
Telefoni : 02 366 05 51 - Fax : 02 390 99 93  
e-mail: [info@cribw.be](mailto:info@cribw.be) – <http://www.cribw.be>

### CRIPEL

Centre Régional pour l'Intégration des Personnes Etrangères ou d'Origine étrangère de Liège  
19B, Place Xavier Neujean -B-4000 Liège  
Telefoni : 04 220 01 20 - Fax : 04 220 01 19  
e-mail : [secretariat@cripel.be](mailto:secretariat@cripel.be) – <http://www.cripel.be>

### CRIC - Centre Régional d'Intégration de Charleroi

23, Rue Hanoteau - B-6060 Gilly  
Telefoni : 071 20 98 60 - Fax : 071 20 98 61  
e-mail: [info@cricharleroi.be](mailto:info@cricharleroi.be) – <http://www.cricharleroi.be>

## APD - Aide aux personnes déplacés

### Liège

93, rue Jean d'Outremeuse - B-4020 Liège

Telefoni : 04 342 14 44 - Fax 04 340 00 90

e-mail : [contact@aideauxpersonnesdeplacees.be](mailto:contact@aideauxpersonnesdeplacees.be)

### Mons

98, rue d'Havré, 98 - B-7000 Mons

Telefoni : 0478 021 990

e-mail: [apd.anneroulet@gmail.com](mailto:apd.anneroulet@gmail.com)

### Braine-le-Comte

#### Le Sylvius

11, rue Adolphe Gillis - B-7090 Braine-le-Comte

Telefoni : 0478 021 990

e-mail : [apd.anneroulet@gmail.com](mailto:apd.anneroulet@gmail.com)

### Huy

33, rue du Marché - B-4500 Huy

Telefoni : 085 21 34 81 - Fax 085 23 01 47

e-mail : [aidepersdepl.huy@skynet.be](mailto:aidepersdepl.huy@skynet.be)

## Në komunitetin Flamanë

### Vluchtelingenwerk Vlanderen

164, rue Gaucheret, B-1030 Bruxelles

Telefoni : 02 274 00 20

E-mail : [info@vluchtelingenwerk.be](mailto:info@vluchtelingenwerk.be) - Faqja e internetit : <http://www.vluchtelingenwerk.be>

### Kruispunt Migratie-Integratie vzw

323/1, Vooruitgangstraat – B-1030 Bruxelles

Telefoni : 02 205 00 50 - Fax : 02 205 00 60

Faqja e internetit : <http://www.kruispuntmi.be/>

### Regionaal Integratiecentrum Foyer

25, Werkhuizenstraat B-1080 Bruxelles

Telefoni : 02 411 74 95 - Fax : 02 411 04 39

E-mail : [foyer@foyer.be](mailto:foyer@foyer.be) - Faqja e internetit : [www.foyer.be](http://www.foyer.be)

### Brussels Onthaalbureau (bon)

23, rue Philippe de Champagne - B-1000 Bruxelles

Telefoni : 02 501 66 80 Fax : 02 289 00 91

E-mail : [info@bonvzw.be](mailto:info@bonvzw.be) - Faqja e internetit : [www.bonvzw.be](http://www.bonvzw.be)

## Shërbimi publik në lidhje me ekuivalencë të diplomës

Fédération Wallonie-Bruxelles

1, rue Adolphe Lavallé- B-1080 Bruxelles

Telefoni : 02 690 86 86

Faqja e internetit : <http://www.equivalences.cfwb.be>

Médiateur de la Fédération Wallonie-Bruxelles

11-13, boîte 17, rue des poissonniers - B-1000 Bruxelles

Telefoni : 02 548 00 70

Faqja e internetit : <http://www.mediateurcfwb.be>

Shërbimet publike regjionale të punës dhe të formacionit

Regjioni Valon : <http://www.leforem.be>

Regjioni i Brukselit-Kryeqendër : <http://www.actiris.be>

Flandër : <http://vdab.be>

Ndihmë për kërkim të studimeve dhe të formacioneve

Ti dini të gjitha mbi arsimin në Belgjikën frankofone : [www.enseignement.be](http://www.enseignement.be)

Të gjitha formacionet për të rriturit në Regjionin e Brukselit : [www.dorifor.be](http://www.dorifor.be)

Shërbimi i informimit mbi studimet dhe profesionet : [www.siep.be](http://www.siep.be)

Aksioni i alfabetizimit në Belgjikën frankofone : [www.lire-et-ecrire.be](http://www.lire-et-ecrire.be)

Tribunali i shkallës së parë i Brukselit

Tribunal de première instance de Bruxelles

1, Place Poelart - B-1000 Bruxelles

Telefoni : 02 508 65 92

Faqja e internetit : [www.juridat.be](http://www.juridat.be) (për të gjitha tribunalet e shkallës së parë të Belgjikës)

Këshilli i Shtetit

Conseil d'État

94-102, rue d'Arlon - B-1040 Bruxelles

Telefoni : 02 234 96 11

Faqja e internetit : <http://www.raadvst-consetat.be/?lang=fr>



coordination et initiatives  
pour réfugiés et étrangers

Créé en 1954, le CIRÉ est une structure de coordination pluraliste réunissant 23 associations aussi diversifiées que des services sociaux d'aide aux demandeurs d'asile, des organisations syndicales, des services d'éducation permanente et des organisations internationales. L'objectif poursuivi est de réfléchir et d'agir de façon concertée sur des questions liées à la problématique des demandeurs d'asile, des réfugiés et des étrangers.

[www.cire.be](http://www.cire.be) - [cire@cire.be](mailto:cire@cire.be)



Ky projekt egziston falë  
përkrahjes së Fondit Europëan  
për Refugjatë (FER)



FÉDÉRATION  
WALLONIE-BRUXELLES

Me përkrahjen e Federatës Valoni - Bruksel

*Viti i shpërndarjes : 2012*

*Ky udhëzues është një vetpërpilim i CIRÉ-s, ve për jokomerciale, riprodhimi dhe modifikimet e saja jan të mundëshme duke cekur referencat e CIRÉ-s.*

*Éditeur përgjegjës : Fred Mawet, drejtoreshë e CIRÉ-s, 80-82, rue du Vivier - B-1050 Bruksel*

*Traduction réalisée par le SeTIS Bruxelles - <http://www.setisbxl.be/>*